Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0584

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj-Mexhuani-Paneliste individuale duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "AS Tech" SH.P.K., me Nr.Protokolli 584/23 të datës 14.08.2023 kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i kondicionerëve në ndërtesat Qeveritare" me numër të prokurimit 214-23-1198-1-2-1, inicuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas mbajtjes së seancës publike për shqyrtimin kryesor, me datë 02.10.2023 merr këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e "AS Tech" SH.P.K. me Nr.Protokolli 2023/0584, e datës 14/08/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i kondicionerëve në ndërtesat Qeveritare", me numër të prokurimit 214-23-1198-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, ndërsa vërtetohet vendimi i AK i datës 28.07.2023 lidhur me aktivitetin e lartcekur.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.02.2023, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i kondicionerëve në ndërtesat Qeveritare", me numër të prokurimit 214-23-1198-1-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratëspër furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 50,000.00 €.

Me 25.05.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë "INFINIT" sh.p.k.

Me 30.05.2023, OE "AS Tech" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 02.06.2023 AK ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim të Operatorit ekonomik ankues dhe ka kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit "Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i kondicionerëve në ndërtesat Qeveritare", me numër të prokurimit 214-23-1198-1-2-1.

Pas rivlerësimit, me datën 28.07.2023 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar aktivitetin e prokurimit të përshkruar si me sipër, me arsyetimin se nuk është pranuar një tender i përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Me 01.08.2023, OE "AS Tech" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 04.08.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit ekonomik ankues dhe ka vërtetuar njoftimin lidhur me anulimin e aktiviteti të prokurimit.

I pakënaqur me Vendimin e AK-së, Operatori ekonomik "AS Tech" SH.P.K, me datë 14.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër protokolli 584/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankese sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues" AS Tech " SH.P.K. janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi i parë (I): "*AK ka bërë shkelje te nenit 59 Neni59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe nenit 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës duke mos e vlerësuar si duhet ofertën e As tech shpk si ofertën e vetme të përgjegjshme. Ofertën tonë e kanë eliminuar*

me arsyetimin se katalogu i ofruar nuk përmban të dhëna të mjaftueshme, kjo fjali e shkurtër përmban dy gabime përmbajtjesorë: Nen 1- nëse katalogu nuk përmban të dhëna të mjaftueshme AK ka pasur mundësi të kërkojë ende sqarime ose të hulumtojë vete tregun dhe këtë brend siç e lejon edhe ligji i prokurimit, sepse ne nuk duhet te eliminohemi për një katalog që nuk përmban të dhëna të mjaftueshëm ndërsa ai katalog prodhohet jashtë shtetit. Nen 2 - Nëse katalogu nuk përmban te dhëna te mjaftueshëm s'do te thotë qe nuk i përmbush specifikimet teknike siç jeni shprehur se rrjedhimisht nuk i përmbush ato. E vetmi devijim qe e keni përmend në letër standarde është një kapacitet e zhurmës së klimës, se ne katalog ka një devijim të vogël. Edhe vete ligji i prokurimit i lejon devijimet e vogla dhe qe nuk kanë ndikim në aspektin material ose përmbajtjesor. Nëse AK është ndalur për ta refuzuar një ofertë sepse nivelin e zhurmës e ka me një devijim te vogël kjo do të thotë që ketu nuk kemi të bëjmë në treg të lirë, por AK paska kërkuar produkte të një brendi ose furnizuesi të caktuar dhe të gjithë të tjerët qenkan të papranueshëm, d.m.th. ju kërkon produkt identik për një kontrate te klimatizimit që nuk është aq e ndjeshme ose specifike që të mos funksionoj në implementim të kontratës ai detaj i vogël."

Pretendimi i dytë (II): *"Në vendim të datës 28.07.2023 AK ka eliminuar ofertën e OE Infinit me arsyetimin se OE ka bërë manipulim të katalogut, pajtohemi me këtë sepse kemi qenë ne ata të cilët kemi bërë kërkesë për rishqyrtim lidhur me këtë në Vendimin e parë të AK-së në muajin maj. Por nuk pajtohemi me atë që AK çështjen e manipulimit e konsideron vetëm një arsye pse oferta e Infinit nuk është shpërblyer dhe nuk na jep dëshmi se ka iniciuar kërkesë për respektim të nenit 99.2 të LPP-se rrjedhimisht propozimin për liste te zeze për OE-en fjalë drejtuar OSHP-së. AK e vëren një manipulim qe OE për te ju përshtatur specifikave të Dosjes i ka bere vete katalogun dhe specifikat por kjo gjë nuk duhet te lejohet sepse manipulimi është rreptësishtë i ndalur ne prokurim. Zyrtari përgjegjës i prokurimit duhet ta këtë obligim që çdo padrejtësi që vëren gjatë procesit të raportoj ashtu siç e thotë edhe ligji i prokurimit. Lidhur me pretendimin nr. 2, për aq sa e vlerësuam vendimin e AK ne kërkesën tonë për rishqyrtim pamë që AK nuk e ka shqyrtuar këtë pretendim."* Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE " AS Tech " SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 60 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, rrjedhimisht vlerësimin e drejtë të ofertës tonë si të vetme të përgjegjshme.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 15.08.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 584/23 ndërsa me datë 25.08.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK."*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. OE "AS Tech" SH.P.K. ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues duke theksuar: *Nuk pajtohemi me mendimin e eksperti që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim për faktin se edhe vete eksperti thotë që pretendimi se AK është dashur të kërkoj sqarime për specifikime me të mëdha është i bazuar prandaj në tërësi ekspertiza është dashur të jetë të paktën pjesërisht e bazuar".* Ndërsa AK ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit, deklarimet e palëve gjate seancës së shqyrtimit kryesor si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Me datën 21.09.2023 është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor lidhur me ketë lëndë ku prezent ishin përfaqësuesit e palës ankuese dhe përfaqësuesit e Autoriteti Kontraktues dhe eksperti shqyrtues.

Përfaqësuesi i palës ankuese gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë pretendimeve ankimore të parashtruara me ankesë dhe ka theksuar se nuk pajtohen me mendimin e eksperti që të refuzohet ankesa për faktin se edhe vete eksperti thotë që pretendimi se AK është dashur të kërkoj sqarime për specifikime me të mëdha është i bazuar prandaj ne tërësi ekspertiza është dashur të jetë të paktën pjesërisht e bazuar. Nisur nga fakti se katalogun e prodhon kompania prodhuese e klimave, nuk ka qene ne kompetencën tone te shtojmë te dhëna ne një dokument qe nuk lëshohet nga ne. AK ka mund te hulumtoj me shume përveç tjerash edhe përmes web faqes ne internet te brendit te klimave ka mund te informohet me shume. E vetmi devijim qe AK e ka përmend ne letër standarde është një kapacitet e zhurmës se klimës, qe ne katallog ka një devijim te vogël. Edhe vete ligji i prokurimit i lejon devijimet e vogla dhe qe nuk kanë ndikim ne aspektin material ose përmbajtjesor. Nëse AK e refuzon një oferte sepse nivelin e zhurmës e ka me një devijim te vogël kjo do te thotë qe këtu nuk kemi te bëjmë ne treg te lire, por AK kërkon produkte te një brendi ose furnizuesi te caktuar dhe gjithë te tjerët janë te papranueshëm, d.m.th. AK kërkon produkt identik për një kontrate te klimatizimit qe nuk është aq e ndjeshme ose specifike qe te mos funksionoj ne implementim te kontratës ai detaj i vogël..

Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar sepasi ka shqyrtuar me kujdes pretendimet e tenderuesit ankues, ka ardhur në përfundim se nuk qëndrojnë pretendimet e tenderuesit ankues "AS Tech" SH.P.K."- Prishtinë,sepse Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit ju ka përmbajtur dhe ka zbatuar nenin 59 par. 4 të LPP-së, citojmë: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".Komisioni i rivlerësimit, ka konstatuar se tenderi i tenderuesit me theks ankuesi është i papërgjegjshëm, sepse për artikullin 1.1 nuk ka ofruar katalog në pajtueshmëri me kërkesën në Specifikimin teknik të DT, konkretisht të niveli i zhurmës: është kërkuar që niveli i zhurmës të jetë 50 dcb, në katalogun e ofruar 07.07.2023 është ofruar 53 Dcb. Rjedhimisht AK, pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, i propozon panelit shqyrtues që ankesa e tenderuesit ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Eksperti Shqyrtues lidhur me pretendimet e OE " AS Tech " SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0584 ka vlerësuar si në vijim: **Pretendimi ankimor është i pa bazuar** pasi që "*Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 584/23 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka ofruar produktin në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit/specifikacionit teknik, konkretisht në pozicionin 1.1 është kërkuar klima me nivel të zhurmës 50 (db)A, ndërsa sipas AK-së OE ankues ka ofruar klimë me nivel të zhurmës 53 decibel. OE ankues përmes ankesës së parashtruar në OSHP pretendon se ky dallim duhet të llogaritet si devijim i vogël dhe se vete ligji i prokurimit i lejon devijimet e vogla dhe qe nuk kanë ndikim ne aspektin material ose përmbajtjesor. Në rastin konkret mendimi ekspertit është se tejkalimi i nivelit të zhurmës së caktuar nga AK, nuk mund të thuhet se nuk përbën devijim nga karakteristikat e parashtruar nga AK, ashtu siç parashihet me nenin 59 par.4, pika (ii) të LPP-së, pasi varësisht nga vendi/hapësira se ku do të vendosen këto klima, niveli më i lartë i zhurmës mund të paraqes pengesë për personat që punojnë në ato hapësira. Në parim pajtohemi me OE ankues se dallimi në nivelin e zhurmës 53 decibel i ofruar, përkundër 50 decibel të kërkuar është dallim i vogël, megjithatë konsiderojmë se klasifikimi si "devijim të vogël" në rastin konkret duhet të jetë në diskrecion të AK-së, pasi në cilësi të ekspertit shqyrtues nuk mund të pohojmë se dallimi për 3 decibel nuk do të paraqes pengesa për AK-në, përderisa AK e konstaton dhe insiston në të kundërtën. Nëse OE ankues pretendon se një kërkesë e tillë (niveli zhurmës) është kërkesë diskriminuese për ndonjë OE apo kërkesë favorizuese për OE tjetër, i njëjti këtë pretendim është dashur ta ngrin pranë AK-së të paktën 5 ditë para hapjes së ofertave në pajtim me dispozitat e nenin 108/A të LPP-së. Sa i përket pretendimit ankimorë për arsye të eliminimit ku sipas AK-së katalogu i ofruar nuk përmban të dhënat e nevojshme, konsiderojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar në kuptim të asaj se AK ka mund të kërkoj informata shtesë nga OE apo edhe nga vet prodhuesi, mirëpo përderisa tanimë është konfirmuar se njëri nga produktet e ofruara nga OE është në kundërshtim me specifikacion teknik, kthimi i lëndës në rivlerësim me qëllim për tu kërkuar sqarime shtesë nuk do ndryshonte faktet tanimë të konfirmuara (tejkalimi nivelit të zhurmës) dhe nuk do sjell ndryshim në rezultat përfundimtar. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, i rekomandojmë panelit shqyrtues që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit.*"

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AS Tech " SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AS Tech" SH.P.K. i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues pas administrimit provave dhe shkresave të kësaj lënde dhe pa ndonjë nevojë që në ketë rast të përshkruhen në detaje pretendimet reciproke të palëve dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, konsideron se: Ankuesi ka dorëzuar katalogun sipas së cilit mund të vërehet se lidhur me produktin e kërkuar (klima) sipas DT janë prezantuar po ashtu edhe specifikat (pa nevojë të përshkruhen) mirëpo vërejtjet parimore të AK i referohen elementeve qenësore të produktit për ushtrimin e atyre funksioneve të cilat AK ka nevojë. Nga ana tjetër ne DT janë paraparë në detaje elementet qenësore (specifikat) të produktit të kërkuar gjë që përshkrimi i këtyre specifikave duket të jetë fare i qartë për çdo furnitor, respektivisht operator ekonomik. Në seancën e shqyrtimin kryesor AK ka pohuar se klimat e ofruara nuk janë sipas specifikacioneve n*ë nivelin e zhurmës 53 decibel i ofruar, përkundër 50 decibel të kërkuar*, andaj nuk janë sipas specifikave të kërkuara. Përderisa Ankuesi ka pohuar se kjo zhurmë nuk mund të vërehet dhe nuk qëndrojnë pretendimet e AK duke theksuar se është dashur të veproj sipas nenit 59 dhe 72 të LPP, kurse eksperti ka konstatuar se kjo diferencë mbetet në diskrecion të AK për vlerësim si inicues të këtij aktiviteti. Në të vërtetë, në pohimet e OE por edhe në raportin e ekspertit shqyrtues nuk gjenden prova jo kontestuese për të vërtetuar faktin se pohime ankimore kanë bazë. Kurse, Paneli konsideron se është jo kontestuese se AK publikisht (përmes publikimit të DT) është deklaruar se ka nevojë për produktin e cilësuar si klima, kurse Ankuesi ka pasur të drejtë që në fazën e para ofertimit të kërkoj sqarime nga AK lidhur me produktin për të cilin oferton i cili nuk është sipas specifikave të kërkuara referuar përshkrimeve si më sipër nga AK në DT. Në rrethana të tilla, Paneli konsideron se anulimi eventual i vendimit të AK dhe/ose rivlerësimi i aktivitetit të prokurimit nuk ofron ndonjë zgjidhje të drejtë për epilogun final të këtij aktiviteti dhe vendosi që vendimin e AK ta konsideroj të bazuar.

Paneli shqyrtues analizoi në kontekstin e përgjithshëm të këtij aktiviteti të gjitha pretendimet reciproke të palëve (Ankuesit dhe AK) dhe ato se çfarë përmban raporti i ekspertit, duke i analizuar me ndërgjegje dhe kujdes profesional dhe erdhi në përfundimin, sipas bindes së tij të pavarur se ankesa nuk mund të pranohet si e bazuar andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik ankues duhet të refuzohet si e pa bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të Vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 28.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i kondicionerëve në ndërtesat Qeveritare", me

numër të prokurimit 214-23-1198-1-2-1.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **" AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: